**LIGJ**
**Nr.10 012, datë 30.10.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8932, DATË 25.7.2002 "PËR DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE SHQIPTARE NË AFGANISTAN, NË KUADËR TË KOALICIONIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8932, datë 26.7.2002 "Për dërgimin e një force ushtarake shqiptare në Afganistan, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit", të ndryshuar, bëhen ky ndryshim dhe kjo shtesë:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1

Republika e Shqipërisë merr pjesë, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit, në Afganistan, me një kompani, së bashku me elementet mbështetëse, një togë, së bashku me elementet mbështetëse, një ekip mjekësor dhe një ekip trajnues (Operational Mentoring Liasion Team, OMLT), efektivë të Forcave të Armatosura.".

Neni 2

Në nenin 2, pas fjalëve "të kompanisë" shtohen fjalët "togës, ekipit mjekësor dhe ekipit trajnues".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5931, datë 11.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**
**Bamir Topi**